



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

Njoftim për pozicion vakant

Në kuadrin e Projektit Tematik “TO BE READY” – “The flood and Big fire foREst, prediction, forecAst anD emergencY management – 355”, me bashkëfinancim nga BE nën IPA, Programi “Interreg IPA CBC Itali–Shqipëri–Mali i Zi 2014/2020”, Ministria e Mbrojtjes fton kandidatët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e punës si vijon:

MENAXHER KOMUNIKIMI për zbatimin e Projektit Tematik “TO BE READY” – “The flood and Big fire foREst, prediction, forecAst anD emergencY management – 355”, bashkëfinancim nga BE nën IPA, Programi “Interreg IPA CBC Itali– Shqipëri–Mali i Zi 2014/2020”.

Detyrat e Menaxherit të Komunikimit:

Menaxheri i komunikimit është përgjegjës për mbikëqyrjen e të gjitha komunikimeve të brendshme dhe të jashtme të projektit, duke siguruar që mesazhi i projektit të jetë i qëndrueshëm dhe tërheqës. Menaxheri i komunikimit do të punojnë për të nxitur imazhin e projektit përmes mesazheve dhe strategjive të qëndrueshme, si dhe mbështetjen e Ministrisë së Mbrojtjes në drejtim të realizimit të synimeve të komunikimit. Duhet të bashkëpunojë ngushtësisht me Menaxherin e Projektit, Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC) në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Partneret e Projektit për të siguruar një paraqitje dhe prezantim efikas të ecurisë dhe realizimit të projektit.

Përgjegjësitë specifike:

- Ofron asistencën e nevojshme Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile/ Ministrisë së Mbrojtjes për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në Paketën e Punës C të projektit (sipas matricës/planit të punës bashkëlidhur).
- Mbështet me eksperiencë, këshilla dhe materiale Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile/ Ministrisë së Mbrojtjes në drejtim të produkteve që realizohen në Paketën e Punës C (PPC) të projektit (sipas matricës/planit të punës bashkëlidhur).
- Hartimi i Planit të Përgjithshëm të Komunikimit i cili siguron qëndrueshmëri dhe forcë në drejtim të vizibilitetit të projektit dhe rrit ndërgjegjësimin ndaj grupeve të synuara.
- Përcaktimi i treguesit kryesorë të performancës për komunikimin, i cili do të tregojë nivelin e suksesit të zhvillimit dhe realizimit të projektit.
- Përcaktimi, zhvillimi dhe zbatimi i fushatave dhe strategjive të komunikimit për produktet e reja të projektit, aktivitetet, ngjarjet dhe promovimet e projektit, si dhe monitoron realizimin e tyre.

- Hapja dhe mirëmbajtja e faqes web të projektit (përmbajtjes së faqes web) dhe rrjeteve të mediave sociale (Facebook, Twitter, Instagram, etj), si dhe përditësim i informacionit.
- Publikimi i dokumenteve teknike të projektit dhe përhapja e tyre drejt operatorëve, audiencës teknike.
- Planifikimi, menaxhimi dhe hartimi i përmbajtjes të materialeve të publikimit të projektit, sipas kërkesave, dhe shpërndarja e tyre drejt shoqatave, grupeve të interesit apo audiencës së gjerë.
- Informacione, materiale dhe njoftime informuese për shtyp në lidhje me projektin, të cilat do të arrijnë lehtësisht tek përfituesit, media dhe më gjerë në mënyrë që zhvillimi dhe realizimi i projektit hap pas hapi të publikohet në një nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Krijimi i lidhjeve me mediat për të ndihmuar që projekti të fitojë ekspozimin në median lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Përgatitje e një liste të shoqatave vullnetare të mbrojtjes civile.
- Përgatitje e listës së grupeve të caktuara ku duam që të arrijë mesazhi dhe qëllimi i realizimit të një projekti të tillë.
- Përgatitje e një adresari me publikime teknike dhe specifike të lidhura me fushën që mbulon projekti.
- Raporte të hollësishme dhe periodike të progresit të aktiviteteve të projektit.
- Pjesëmarrje aktive në aktivitete në kuadër të zbatimit të projektit.
- Pjesëmarrja dhe angazhimi në grupe të ndryshme pune të krijuar me qëllim zbatimin e “TO BE READY”.
- Detyra të tjera të ngarkuara brenda fushës së eksperiencës.

Kërkesa të përgjithshme për pranimin e kandidatëve

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të jetë i aftë për të vepruar.
- Të përmbushë kërkesat ligjore lidhur me nivelin e edukimit, si dhe të ketë aftësi të nevojshme profesionale për punën përkatëse, siç kërkohet në këtë njoftim.
- Të jetë i shëndetshëm, në mënyrë që të përmbushë detyrat përkatëse.
- Të mos jetë dënuar për krime.

Edukimi, kualifikimi dhe eksperiencia

- Diplomë e nivelit Master Shkencor.
- Përvojë pune si profesionist së paku 3 vjet.
- Eksperiencë pune me projektet e financuara nga BE.
- Njohuri të forta mbi praktikat dhe teknikat e komunikimit.
- I aftë të punojë si pjesë e një ekipi, si dhe në mënyrë të pavarur.
- Eksperiencë në pjesëmarrje në grupe multi-disiplinore.
- Duhet të jetë në gjendje të përmbushi detyra të ndryshme dhe të punojë mirë nën presion;
- Aftësi të larta në komunikim me shkrim dhe verbal.
- Shqipe dhe Anglishte e rrjedhshme (në të shkruar dhe të folur).

- Eksperiencë në komunikim me zyrtarë të lartë në rang kombëtar dhe/ose lokal.
- Njohje të rregullave dhe legjislacionit të BE-së dhe legjislacionin vendas që lidhen me ndihmën e huaj.

Kërkesa të tjera

- Aftësi konceptuale, kërkimore dhe analitike për të integruar informacione nga burime të ndryshme në përfundime dhe rekomandime vepruese.
- Aftësi ndër personale dhe të provuara në punë në mjedise multi-kulturore.
- Përgjegjësi e lartë, iniciativë dhe korrektësi.
- Diplomaci dhe aftësi për të inkurajuar dhe lehtësuar bashkëpunimin midis entiteteve qeveritare.
- Aftësi të mira kompjuterike, përfshirë Word dhe Excel

Kushtet e punësimit

Kandidati i përzgjedhur punësohet me kohë të pjesshme - dedikuar për projektin me një përqindje fleksibël të kohës dhe nënshkruan një kontratë me afat të caktuar me Ministrinë e Mbrojtjes.

Procedura e aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentet e aplikimit si më poshtë:

- Curriculum vitae (CV) në formatin Evropian.
- Fotokopje të diplomave universitare, master, PhD.
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID).
- Fotokopje të librezës së punës.
- Vetë deklaram të gjendjes gjyqësore.
- Formularin e vetë deklaramit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM, në faqen elektronike www.mod.gov.al (linku: baza ligjore/aktet ligjore/integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i deklaramit).
- Fotokopje të Diplomave/Certifikatave që provojnë njohuritë e gjuhës angleze (nëse diploma universitare është marrë në një program studimi në gjuhën angleze ose italiane, nuk është e nevojshme dëshmia e gjuhës).
- Dokumente të tjera mbështetëse (certifikata të fituara nga trajnime, pjesëmarrje në konferenca, botime, letra reference, etj).

Dorëzimi i dokumenteve

Kandidatët e interesuar duhet t'i dorëzojnë dokumentet e aplikimit me postë ose drejtpërdrejtë deri më datë 24/10/2020, ora 16.00, në adresën si në vijim: Ministria e Mbrojtjes, Rr. Dibrës, 1001, Tiranë, Shqipëri, me subjekt:

Aplikim për pozicionin Menaxher Komunikimi, i Projektit Tematik “TO BE READY” – “The flood and Big fire foREst, prediction, forecAst anD emergencY management – 355”, INTERREG IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi.

Ministria e Mbrojtjes, 5 ditë mbas mbylljes së afatit të dorëzimit të dokumenteve nga kandidatët do të shpallë në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta të pozicionit, si dhe vendin dhe orën e zhvillimit të intervistës.

Intervista do të zhvillohet në ambientet e Ministrisë së Mbrojtjes.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me pozicionin e punës (Fushën e njohurisë si më poshtë).
- Eksperiencën e tyre të mëparshme.
- Motivimi, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Ministria e Mbrojtjes do t'i njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës e-mail) dhe do të shpallë fituesin në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes.

Fusha e Njohurisë:

- Ligji Nr. 37/2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Para anëtarësimit (IPA II)”.
- Ligji nr. 138/2016, “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian për programin INTERREG IPA të bashkëpunimit ndërkuftar Itali-Shqipëri-Mali i Zi, 2014-2020”.
- Ligji 45/2019 “Për mbrojtjen civile”.
- VKM Nr.541 datë 18.6.2015 Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësive dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit indirekt të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para anëtarësimit IPA II (2014 – 2020).
- Instrumentit të Asistencës së Para anëtarësimit IPA II (2014 – 2020) – faqja zyrtare e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.
- Menaxhimi i fondeve IPA sipas rregullave të PRAG (<http://ec.europa.eu/europeaid/prag/document.do?nodeNumber=1>).
- Dokumentet e tjerë të programit (<https://www.italy-albania-montenegro.it>).
- Plani Kombëtar për emergjencat Civile (<http://www.mbrojtja.gov.al/images/ec/PlaniKombetar-EC.pdf>).